



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBETARE E PERMBARUESVE GJYQESOR PRIVAT  
ZYRA E PERMBARIMIT PRIVAT „ENFORCEMENT GROUP“ SHPK  
Adresa : Blv. « Gjergj Fishta », Kulla Nr.1, Pall.Shoqerise « Gora », Kati 3, Ap.14,  
Tirane. , Cel. 0672022667 e-mail : enforcementgroup2014@gmail.com

Nr. 28/11 Prot.  
Nr. 1816 Regj

Tiranë më, 01.06.2020.

**URDHËR  
PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE  
MBI KUOTAT E DEBITORIT**



**Drejtuar :** Qendres Kombetare te Biznesit ✓  
**Adresa :** Tiranë  
**Për dijëni:** Debitorit OSHEE Group sha Nipt K72410014H / Tiranë  
**Për dijëni:** Shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sha Nipt L81530018E  
**Për dijëni:** Shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sha Nipt L81530016L  
**Për dijëni:** Shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sha Nipt L81530016L  
**Adresa:** Tiranë

Unë, Engjell Muskaj me detyrë Përmbarues Gjyqësor Privat, pranë Zyrës Përmbarimore Private “Enforcement Group” shpk, pasi studiova materialet e dosjes Nr. 1816 Regj, bazuar në Titullin Ekzekutiv Vendimi gjyqësor Nr. 62-2018-3990 (1058) datë 23.07.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, lënë në fuqi me vendimin Nr. 780 datë 05.12.2019 Gjykata e Apelit Vlorë,

**KONSTATOVA:**

Se pranë Zyrës Përmbarimore Private “Enforcement Group” shpk është depozituar për ekzekutim, kërkesa e palës kreditore Myqerem Hilmi Malaj, së bashku me Titullin Ekzekutiv Vendimi gjyqësor Nr. 62-2018-3990 (1058) datë 23.07.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, lënë në fuqi me vendimin Nr. 780 datë 05.12.2019 Gjykata e Apelit Vlorë, me palë e objekt:

-Kreditor: Myqerem Hilmi Malaj  
-Debitor: Operatori i Shperndarjes se Energjisë Elektrike sha, sot OSHEE Group sh.a. Nipt K72410014H  
-Objekti: Pagim Page

**Me anë të këtij titulli ekzekutiv është vendosur:**

-Pranimi i padisë  
-Detyrimi i palës së paditur Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sha, ti paguajë paditësit Myqerem Malaj dy paga mujore për mosrespektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës.  
-Detyrimi i palës së paditur Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sha, ti paguajë paditësit Myqerem Malaj tetë paga mujore si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.  
-Detyrimi i palës së paditur Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sha, ti paguajë paditësit Myqerem Malaj dy paga mujore si shpërblim për vjetërsinë në punë.  
-Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur në përpjestim me pjesën e pranuar të padisë.

Nga ana jonë janë kryer një sërë veprimesh përmbarimore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv të përmendur më sipër, por pa sukses. Gjatë kryerjes së procedurave përmbarimore ka rezultuar se Shoqëria OSHEE GROUP sha bazuar në disa vendime të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë të publikuara në faqen e saj

zyrtare, si dhe VKM Nr. 244 datë 30.03.2016, në Ligjin Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë" ka krijuar 3 Shoqëri Bija duke e transferuar aktivitetin e saj financiar në këto shoqëri.

Konkretisht që prej fillimit të vitit 2020 janë krijuar:

- 1- Shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sha Nipt L81530018E
- 2- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sha Nipt L81530016L
- 3- Shoqëria Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sha Nipt L81530016L

Pronar i aksioneve të këtyre tre shoqërive është pikërisht debitori "OSHEE Group" sh.a. me Nipt K72410014H

***Për sa më sipër:***

Në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile, Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

**URDHËROJ:**

1.Vendosjen e masës së sekuestros konservative në aksionet e pronarit "OSHEE Group" sh.a. me NIPT K72410014H, në shoqëritë si më poshtë:

- 1.1-Shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sha Nipt L81530018E
- 1.2-Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sha Nipt L81530016L
- 1.3-Shoqëria Furnizuesi i Tregut të Lirë (FTL) sha Nipt L81530016L

2.Kuotat e mesiperme do te qendrojne te sekuestruara deri ne nje urdher te dyte nga ana e zyres sone permbarimore.

3.Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet te na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

4.Per personat që bëhen pengesë ne zbatimin e ketij urdheri do të merren te gjitha masat e parashikuara ne neni 606 te K.Pr.Civile, si dhe ne rast se ka vend do te kerkohej ndjekje penale ne baze te dispozitave te Kodit Penal.

5.Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 te K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja dijeni.

6.Pas dergeses se ketij urdheri per vendosjen e sekuestros konservative mbi aksionet e debitorit te sipercituar ne shoqerite e sipercituara, kerkojme te na dergohet prane zyres sone statusi i aksioneve pas kryerjes se bllokimit, brenda afatit ligjor.

ZYRA E PERMBARIMIT PRIVAT "ENFORCEMENT GROUP" SHPK

PËRMBARUESI GJYQËSOR

ENGJELL MUSKAJ